



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 23 paragrafi 5 të Rregullores së Punës së KQZ-së, si dhe duke u bazuar në vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës të datës 21.06.2017, për shpalljen e Zgjedhjeve Lokale të datës 22 tetor 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 08.07.2017, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Organogrami të Stafit Jo Permanent për Zgjedhjet Lokale 2017

- I. Miratohet organogrami për angazhimin e stafit jo permanent, për zgjedhjet lokale, që do të mbahen më 22 tetor 2017.
- II. Sekretariatit i lejohet mundësia që nëse e konsideron të nevojshme mund të shtoj numrin e stafit jopermanent, sipas nevojës dhe kërkesave të departamenteve.
- III. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së për ndërmarrjen e procedurave administrative, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi.
- IV. Organogrami është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 08.07. 2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka